

31984L0253

Direktiva e Tetë e Këshillit 84/253/KEE, datë 10 prill 1984, mbështetur në nenin 54 pika 3 germa "g" të Traktatit për miratimin e personave përgjegjës për kryerjen e auditimeve ligjore të dokumenteve kontabël

Gazeta Zyrtare L 126 , 12/05/1984 fq. 0020 - 0026

Botimi i posaçëm në gjuhën finlandeze: Kapitulli 17 Vëllimi 1 fq. 0073

Botimi i posaçëm në gjuhën spanjolle Kapitulli 17 Vëllimi 1 f. 0136 Botimi i posaçëm suedez Kapitulli 17 Vëllimi 1 f. 0073

Botimi i posaçëm në gjuhën portugeze Kapitulli 17 Vëllimi 1 fq. 0136

Direktiva e Tetë e Këshillit, datë 10 prill 1984, mbështetur në nenin 54 pika 3 germa "g" të Traktatit për miratimin e personave përgjegjës për kryerjen e auditimeve ligjortë dokumenteve kontabël (84/253/KEE)

KËSHILLI I KOMUNITETEVE EUROPIANE,

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Ekonomik Europian dhe në veçanti nenin 54 pika 3 germa "g" të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit [1],

Duke pasur parasysh opinionin e Parlamentit Europian [2],

Duke pasur parasysh opinionin e Komitetit Ekonomik dhe Social (3),

Meqë, sipas Direktivës 78/660/KEE, llogaritë vjetore të disa llojeve të caktuara të shoqërive tregtare duhen audituar nga një a më shumë persona që kanë të drejtë të kryejnë auditime të tilla, prej nga mund të përjashtohen vetëm shoqëritë tregtare e përmendura në nenin 11 të Direktivës së lartpërmendur;

Meqë Direktiva e lartpërmendur është plotësuar me Direktivën 83/349/KEE (5) për llogaritë e konsoliduara;

Meqë është mirë të harmonizohen kushtet kualifikuese që duhet të plotësojnë personat të cilëve u jepet e drejta për të kryer auditimet ligjore të dokumenteve kontabël ; meqë është mirë të sigurohet që këta persona të jenë të pavarur dhe me reputacion të mirë;

Meqë niveli i lartë i njohurive teorike të nevojshme për auditimin ligjor të dokumenteve kontabël dhe aftësia për të vënë në jetë këto njohuri duhen siguruar nëpërmjet provimit të aftësisë profesionale;

Meqë është mirë që Shteteve Anëtare t'u jepet kompetenca për miratimin e personave që, edhe pse nuk i përmbushin të gjitha kriteret e vendosura në lidhje me formimin teorik, janë të angazhuar në veprimtari profesionale prej një kohe të gjatë, çka u jep atyre përvojë të mjaftueshme në fushat e financës, drejtësisë dhe kontabilitetit, dhe e kanë kaluar me sukses provimin e aftësisë profesionale;

Meqë Shtetet Anëtare duhet gjithashtu të autorizohen për të miratuar dispozita kalimtare në të mirë të profesionistëve;

Meqë Shtetet Anëtare do të mund të miratojnë personat fizikë, dhe firmat e audituesve që mund të jenë persona juridikë apo lloje të tjera shoqërisht tregtare, firmash apo shoqërisht të thjeshta;

Meqë personat fizikë që kryejnë auditimin ligjor të dokumenteve kontabël për llogari të këtyre firmave të audituesve kanë detyrimin për të përmbushur kushtet e kësaj Direktive;

Meqë Shteti Anëtar do të mund të miratojë persona që i kanë plotësuar kushtet e kualifikimit të barasvlershme me kushtet e kualifikimit që kërkon kjo Direktivë, jashtë atij Shteti ;

Meqë Shteti Anëtar që, në momentin e miratimit të kësaj Direktive, njeh kategori të personave fizikë që i përmbushin kushtet e vendosura në këtë Direktivë, por niveli i provimit të aftësisë profesionale të të cilëve është poshtë nivelit të provimit përfundimtar universitar, duhet të lejohet të vijojë, në kushte të caktuara dhe gjer në bashkërendimin e mëpasshëm, t'u japë këtyre personave miratimin të posaçëm në funksion të kryerjes së auditimit ligjor të dokumenteve kontabël të shoqërive tregtare dhe organeve të ndërmarrjeve, të një madhësie të kufizuar, kur Shteti Anëtar nuk i ka shfrytëzuar mundësitë e përjashtimit të cilat vihen në dispozicion me Direktivat e Komunitetit në lidhje me përgatitjen e llogarive të konsoliduara;

Meqë kjo Direktivë nuk mbulon, as të drejtën e themelimit/krijimit, as lirinë e ofrimit të shërbimeve, në lidhje me personat përgjegjës për kryerjen e auditimeve ligjore të dokumenteve kontabël;

Meqë njohja e miratimit që u bëhet shtetasve të Shteteve të tjera Anëtare në funksion të kryerjes së auditimeve të tilla do të rregullohet konkretisht me direktivat për fillimin dhe kryerjen e veprimtarive në fushat e financës, ekonomisë dhe kontabilitetit, si edhe me lirinë për të ofruar shërbime në këto fusha,

KA MIRATUAR KËTË DIREKTIVË

SEKSIONI I Objekti

Neni 1

1. Masat e bashkërendimit që parashikon kjo Direktivë zbatohen për aktet ligjore, nënligjore dhe administrative të Shteteve Anëtare që kanë të bëjnë me personat përgjegjës për: (a) kryerjen e auditimeve ligjore të llogarive vjetore të shoqërive tregtare dhe firmave dhe kryerjen e verifikimit të raporteve vjetore për të parë nëse janë në përputhje me llogaritë vjetore, për aq sa këto auditime dhe verifikime i kërkon legjislacioni i Komunitetit;

(b) kryerjen e auditimeve ligjore të llogarive të konsoliduara të grupeve të ndërmarrjeve dhe verifikimin e raporteve vjetore të konsoliduara për të parë nëse janë në përputhje me llogaritë e konsoliduara, për aq sa këto auditime dhe verifikime i kërkon legjislacioni i Komunitetit.

2. Personat e përmendur në pikën 1 mund të jenë, në varësi të legjislacionit të secilit Shtet Anëtar, persona fizikë ose juridikë ose lloje të tjera të shoqërive tregtare, firmave apo shoqërive të thjeshta (firma të audituesve sipas përkufizimit të kësaj Direktive).

SEKSIONI II Rregullat për miratimin

Neni 2

1. Auditimet e detyrueshme të dokumenteve të përmendura në nenin 1 pika 1 kryhen vetëm nga personat e miratuar Organet e Shteteve Anëtare mund të miratojnë vetëm: (a) personat fizikë që përmbushin të paktën kushtet e parashikuara në nenet nga 3 deri në 19;

(b) firmat e audituesve që përmbushin të paktën kushtet e mëposhtme: (i) nëse personat fizikë që kryejnë auditime ligjore të dokumenteve të përmendura në nenin 1 për llogari të firmave të audituesve duhet të përmbushin të paktën kushtet e vendosura në nenet nga 3 deri në 19 ; Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që edhe këta persona fizikë duhet të jenë të aprovuar;

(ii) personat fizikë ose firmat e audituesve që përmbushin të paktën kushtet e vendosura në nenet nga 3 deri në 19 me përjashtim të nenit 11 pika 1 germa "b" duhet të zotërojnë shumicën e të drejtave të votës ; Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që edhe këta persona fizikë ose firma të audituesve duhen miratuar. Sidoqoftë, Shteti Anëtar që nuk e kërkon një shumicë të tillë në momentin e miratimit të kësaj Direktive nuk ka nevojë ta vendosë këtë kërkesë nëse të gjitha aksionet e firmës së audituesve janë të regjistruara dhe të mund të transferohen vetëm me miratimin e firmës së audituesve dhe/ose, nëse kjo parashikohet nga Shteti Anëtar, me miratimin e autoritetit kompetent;

(iii) shumica a anëtarëve të organit administrativ të firmës së audituesve duhet të jenë persona fizikë ose firma të audituesve që përmbushin të paktën kushtet e vendosura në nenet nga 3 deri në 19 ; Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që edhe këta persona fizikë ose firma të audituesve duhen aprovuar. Kur organi i tillë nuk ka më shumë se dy anëtarë, njëri prej anëtarëve duhet të përmbushë të paktën kushtet e lartpërmendura.

Pa cenuar nenin 14 pika 2, miratimi i firmës së audituesve duhet të shfuqizohet nëse nuk përmbushet më ndonjëri prej kushteve të vendosura sipas germës "b". Sidoqoftë, Shtetet Anëtare mund të parashikojnë një periudhë faljeje jo më të gjatë se dy vjet me qëllim përmbushjen e kërkesave të vendosura në germën "b" nën-pikat "ii" dhe "iii".

2. Në kuptim të kësaj Direktive, autoritetet e Shteteve Anëtare mund të jenë shoqata profesionale, me kusht që legjislacioni kombëtar t'i ketë autorizuar të japin miratimin e përkufizuar në këtë Direktivë.

Neni 3

Autoritetet e Shtetit Anëtar u japin miratimin vetëm personave me reputacion të mirë që nuk kryejnë veprimtari të cilat, sipas legjislacionit të Shtetit Anëtar, nuk janë të pajtueshme me auditimin ligjor të dokumenteve të përmendura në nenin 1 pika 1.

Neni 4

Personi fizik miratohet të kryejë auditime ligjore të dokumenteve të përmendura në nenin 1 pika 1 vetëm pasi të ketë kaluar nivelin e pranimit në universitet, të ketë përfunduar kursin teorik, të ketë kryer formimin praktik dhe të ketë kaluar me sukses provimin e aftësisë profesionale në universitet, në nivelin e provimit përfundimtar ose të njohur nga Shteti.

Neni 5

Provimi i aftësisë profesionale i përmendur në nenin 4 duhet të garantojë nivelin e nevojshëm të njohurive teorike në lëndët e lidhura me auditimin ligjor të dokumenteve të përmendura në nenin 1 pika 1 dhe aftësinë për t'i zbatuar në praktikë këto njohuri.

Të paktën një pjesë e këtij provimi duhet të jetë me shkrim.

Neni 6

Teksti i njohurive teorike të përfshira në provim duhet të mbulojë në veçanti lëndët e mëposhtme: (a) - auditim,

- analizë dhe vlerësim kritik i llogarive vjetore,
- kontabilitet i përgjithshëm,
- llogaritë e konsoliduara,
- kontabilitet drejtimi dhe kostoje,
- auditim i brendshëm,
- standardet e lidhura me përgatitjen e llogarive vjetore dhe të konsoliduara dhe me mënyrat e vlerësimit të zërave të bilancit dhe mënyrat e llogaritjes së fitimit dhe humbjes,
- standardet ligjore dhe profesionale në lidhje me auditimin e ligjor të dokumenteve kontabël dhe me ata që e bëjnë auditimin;

(b) për aq sa kanë lidhje me auditimin: - legjislacioni për shoqëritë tregtare,

- legjislacioni për falimentimin dhe procedurat e ngjashme,
- legjislacioni tatimor,
- e drejta civile dhe tregtare,
- legjislacioni për sigurimet shoqërore dhe legjislacioni për marrëdhëniet e punës,
- sistemet informatike dhe kompjuterike,
- njohuri ekonomike të biznesit, të përgjithshme dhe financiare,
- matematikë dhe statistikë,

- parimet bazë të drejtimit financiar të ndërmarrjeve.

Neni 7

1. Si përjashtim nga neni 5 dhe 6, Shteti Anëtar mund të parashikojë që personi që e ka kaluar me sukses provimin universitar ose një provim të barasvlershëm ose që ka diplomë universiteti apo një kualifikim të barasvlershëm në një a më shumë prej fushave të përmendura në nenin 6 mund të përjashtohet nga testimi i njohurive teorike në lëndët që mbulon provimi ose diploma.

2. Si përjashtim nga neni 5, Shteti Anëtar mund të parashikojë që personi që ka diplomë universiteti ose një kualifikim të barasvlershëm në një a më shumë prej fushave të përmendura në nenin 6 mund të përjashtohet nga testimi i aftësisë për zbatimin në praktikë të njohurive teorike në këto lëndë nëse e ka kryer praktikën për to, e vërtetuar me një provim a diplomë të njohur nga Shteti.

Neni 8

1. Për të siguruar se personi i trajnuar gëzon aftësinë për zbatimin në praktikë të njohurive teorike, testimi i të cilave është përfshirë në provim, ai duhet të bëjë të paktën tre vjet praktikë, ndër të tjera, në auditimin e llogarive vjetore, llogarive të konsoliduara apo të pasqyrave të ngjashme financiare. Të paktën dy të tretat e këtij formimi praktik duhet të kryhet pranë një personi të miratuar sipas legjislacionit të Shtetit Anëtar në përputhje me këtë Direktivë ; sidoqoftë, Shteti Anëtar mund të lejojë që formimi praktik të kryhet pranë një personi të miratuar sipas legjislacionit të një Shteti Anëtar tjetër në përputhje me këtë Direktivë.

2. Shtetet Anëtare kujdesen që çdo formim të bëhet pranë personave që ofrojnë garanci të mjaftueshme për sa i takon formimit.

Neni 9

Shtetet Anëtare mund të aprovojnë personat që të kryejnë auditimet ligjore të përmendura në nenin 1 pika 1 edhe nëse nuk i përmbushin kushtet e vendosura në nenin 4, nëse mund të dëshmojnë që: (a) kanë 15 vjet që janë angazhuar në veprimtari profesionale që u ka dhënë atyre mundësi të fitojnë përvojë të mjaftueshme në fushat e financës, të drejtës dhe kontabilitetit dhe e kanë kaluar me sukses provimin e aftësisë profesionale të përmendur në nenin 4, ose

(b) kanë 7 vjet të angazhuar në veprimtari profesionale në këto fusha dhe, krahas kësaj, kanë kryer praktikën e përmendur në nenin 8 dhe e kanë kaluar me sukses provimin e aftësisë profesionale të përmendur në nenin 4.

Neni 10

1. Shtetet Anëtare mund të zbresin, nga vitet e veprimtarisë profesionale të përmendura në nenin 9, periudhën e formimit teorik në fushat e përmendura në nenin 6, me kusht që formimi teorik të jetë testuar me një provim të njohur nga Shteti. Ky formim teorik duhet të zgjasë jo

më pak se një vit dhe nuk mund ta shkurttojë periudhën e veprimtarisë profesionale me më shumë se katër vjet.

2. Periudha e veprimtarisë profesionale si edhe e formimit praktik nuk duhet të jetë më e shkurtër se programi i formimit teorik dhe i formimit praktik që kërkon neni 4.

Neni 11

1. Autoritetet e Shtetit Anëtar mund t'i miratojnë personat që i kanë fituar një pjesë ose të gjitha kualifikimet në një Shtet tjetër nëse përmbushin dy kushtet e mëposhtme: (a) autoritetet kompetente duhen t'i konsiderojnë kualifikimet e tyre të barasvlershme me kualifikimet që kërkon legjislacioni i Shtetit Anëtar në përputhje me këtë Direktivë ; dhe

(b) personat duhet të kenë paraqitur provë të njohurive ligjore siç kërkohet në këtë Shtet Anëtar në funksion të auditimit ligjor të dokumenteve të përmendura në nenin 1 pika 1. Megjithatë, autoritetet e këtij Shteti Anëtar nuk është nevoja ta kërkojnë një vërtetim të tillë nëse i konsiderojnë të mjaftueshme njohuritë ligjore të fituara në një Shtet Anëtar tjetër.

2. Zbatohet Neni 3.

Neni 12

1. Shteti Anëtar mund të konsiderojë si të miratuar, në përputhje me këtë Direktivë, profesionistët që janë miratuar me akte të veçanta të autoriteteve kompetente të Shtetit Anëtar përpara zbatimit të dispozitave të përmendura në nenin 30 pika 2.

2. Anëtarësimi i personit fizik në një shoqatë profesionale të njohur nga Shteti ku, në përputhje me legjislacionin e atij Shteti, ky anëtarësim i jep anëtarit të shoqatës të drejtën për të kryer auditime ligjore të dokumenteve të përmendura në nenin 1 pika 1, mund të konsiderohet si miratim me akt të veçantë në kuptimin e pikës 1 të këtij neni.

Neni 13

Gjer në zbatimin e dispozitave të përmendura në nenin 30 pika 2, Shteti Anëtar mund t'i konsiderojë si të miratuar , në përputhje me këtë Direktivë, profesionistët që nuk janë miratuar me akte të veçanta të autoriteteve kompetente, por që kanë të njëjtat kualifikime në këtë Shtet Anëtar me personat që janë miratuar me akte të veçanta dhe që, në datën e miratimit , kanë kryer auditime ligjore të dokumenteve të përmendura në nenin 1 pika 1 për llogari të personave të miratuar .

Neni 14

1. Shteti Anëtar mund të konsiderojë si të miratuar , në përputhje me këtë Direktivë, ato firma të audituesve që janë miratuar me akte të veçanta të autoriteteve kompetente të Shtetit Anëtar përpara zbatimit të dispozitave të përmendura në nenin 30 pika 2.

2. Kushtet e vendosura në nenin 2 pika 1 germa "b" nënpikat "ii" dhe "iii" duhen zbatuar jo më vonë se fundi i periudhës që nuk mund të jetë më shumë se pesë vjet nga data e zbatimit të dispozitave të përmendura në nenin 30 pika 2.

3. Personat fizikë të cilët, deri në zbatimin e dispozitave të përmendura në nenin 30 pika 2, kanë kryer auditime të detyrueshme të dokumenteve të përmendura në nenin 1 pika 1 në emër të një firme audituesish mund të autorizohen, pas kësaj date, të vazhdojnë të kryejnë auditime të tilla edhe nëse nuk i përmbushin të gjitha kushtet që vendos kjo Direktivë.

Neni 15

Deri në një vit pas zbatimit të dispozitave të përmendura në nenin 30 pika 2, profesionistët që nuk janë miratuar me akte të veçanta të autoriteteve kompetente por që, sidoqoftë, i përmbushin kushtet kualifikuese në një Shtet Anëtar për kryerjen e auditimeve ligjore të dokumenteve të përmendura në nenin 1 pika 1 dhe faktikisht i kanë kryer këto veprimtari gjer më këtë datë mund të miratohen nga Shteti Anëtar në përputhje me këtë Direktivë.

Neni 16

Për një periudhë njëvjeçare pas zbatimit të dispozitave të përmendura në nenin 30 pika 2, Shtetet Anëtare mund të zbatojnë masa kalimtare në lidhje me personat profesionistë të cilët, pas kësaj date, e ruajnë të drejtën për të audituar dokumentet vjetore kontabël të disa llojeve të caktuara të shoqërive tregtare apo firmave të cilat nuk i nënshtrohen detyrimit për auditim ligjor por që pas futjes në përdorim të auditimeve të reja të detyrueshme nuk do të mund të kryejnë më auditime të tilla, nëse nuk miratohen masa të posaçme në favor të tyre.

Neni 17

Për nenin 15 dhe nenin 16 zbatohet neni 3.

Neni 18

1. Për një periudhë gjashtëvjeçare pas zbatimit të dispozitave të përmendura në nenin 30 pika 2, Shtetet Anëtare mund të zbatojnë masa kalimtare në lidhje me personat që e kanë filluar më parë formimin profesional apo praktik në momentin e zbatimit të këtyre dispozitave dhe që, pas përfundimit të formimit, nuk do t'i përmbushnin kushtet e vendosura nga kjo Direktivë dhe për rrjedhojë nuk do të ishin në gjendje të kryenin auditime ligjore të dokumenteve të përmendura në nenin 1 pika 1 për të cilat janë trajnuar.

2. Zbatohet Neni 3.

Neni 19

Asnjëri prej profesionistëve të përmendur në nenin 15 dhe 16 apo prej personave të përmendur në nenin 18 nuk mund të miratohen në shmangie të nenit 4 nëse autoritetet kompetente nuk mendojnë se këta persona janë të aftë për kryerjen e auditimeve ligjore të dokumenteve të përmendura në nenin 1 pika 1 dhe i kanë kualifikimet e barasvlershme me ato të personave të aprovuar sipas nenit 4.

Neni 20

Shteti Anëtar i cili nuk e përdor mundësinë e parashikuar në nenin 51 pika 2 të Direktivës 78/660/KEE dhe në të cilin, në momentin e miratimit të kësaj Direktive, disa kategori personash fizikë lejohen nga legjislacioni kombëtar të kryejnë auditime ligjore të dokumenteve të përmendura në nenin 1 pika 1 germa "a" të kësaj Direktive, mundet që, gjer në bashkërendimin e mëpasshëm të auditimit të detyrueshëm të dokumenteve kontabël, të miratojë posaçërisht, në kuptim të kryerjes së auditimeve të detyrueshme të dokumenteve të përmendura në nenin 1 pika 1 germa "a" në rastin e shoqërisë tregtare që nuk i kalon kufijtë e dy prej tre kritereve të vendosura në nenin 27 të Direktivës 78/660/KEE, persona fizikë që veprojnë për llogari të vetedhe që: (a) i përmbushin kushtet e vendosura në nenet nga 3 deri në 19 të kësaj Direktive, por niveli i provimit të aftësisë profesionale mund të jetë më i ulët nga ai që kërkon neni 4 i kësaj Direktive ; dhe

(b) kanë kryer që më parë auditimin ligjor shoqërisë tregtare në fjalë përpara se kjo shoqëri tregtare t'i kalojë kufijtë e dy prej tre kritereve të vendosura në nenin 11 të Direktivës 78/660/KEE.

Megjithatë, nëse shoqëria tregtare është pjesë e një grupi ndërmarrjesh që konsolidohen dhe që i kalon kufijtë e dy prej tre kritereve të vendosura në nenin 27 të Direktivës 78/660/KEE, këta persona nuk mund ta kryejnë auditimin ligjor të dokumenteve të përmendura në nenin 1 pika 1 germa "a" të kësaj Direktive në rastin e kësaj shoqërie tregtare.

Neni 21

Shteti Anëtar, që nuk e përdor mundësinë e parashikuar në nenin 6 pika 1 të Direktivës 83/349/KEE dhe në të cilin, kur miratohet kjo Direktivë, disa kategori të caktuara personash fizikë mund të kryejnë, në bazë të legjislacionit kombëtar, auditime ligjore të dokumenteve të përmendura në nenin 1 pika 1 germa "b" të kësaj Direktive, mundet që, gjer në bashkërendimin e mëpasshëm të auditimit të detyrueshëm të dokumenteve kontabël, të miratojë posaçërisht për kryerjen e auditimeve ligjore të dokumenteve të përmendura në nenin 1 pika 1 germa "b", një person të miratuar sipas nenit 20 të kësaj Direktive nëse më datën e bilancit të shoqërisë mëmë, grupimi i ndërmarrjeve që konsolidohen nuk i kalon, sipas llogarive më të fundit vjetore të këtyre ndërmarrjeve, kufijtë e dy prej tre kritereve të vendosura në Nenin 27 të Direktivës 78/660/KEE, me kusht që këtij personi t'i jetë dhënë e drejta për kryerjen e auditimit ligjor të dokumenteve të përmendura në nenin 1 pika 1 germa "a" të kësaj Direktive për të gjitha ndërmarrjet e përfshira në konsolidim.

Neni 22

Shteti Anëtar që e përdor nenin 22 mund të lejojë që formimi praktik i personave në fjalë të përmendur në nenin 8 të bëhet pranë një personi që është miratuar sipas legjislacionit të Shtetit Anëtar për të kryer auditimet ligjore të përmendura në nenin 20.

SEKSIONI III

Integriteti dhe pavarësia profesionale

Neni 23

Shtetet Anëtare parashikojnë që personat e miratuar për auditimin ligjor të dokumenteve të përmendura në nenin 1 pika 1 t'i kryejnë këto auditime me integritet profesional.

Neni 24

Shtetet Anëtare parashikojnë që këta persona të mos kryejnë auditimet ligjore të kërkuara prej tyre nëse këta persona nuk janë të pavarur në përputhje me legjislacionin e Shtetit Anëtar që e kërkon auditimin.

Neni 25

Neni 23 dhe 24 zbatohet edhe për personat fizikë që i përmbushin kushtet e vendosura në nenet nga 3 deri në 19 dhe e kryejnë auditimin e detyrueshëm të dokumenteve të përmendura në nenin 1 pika 1 në emër të një firme audituesish.

Neni 26

Shtetet Anëtare kujdesen që personat e miratuar t'u nënshtrohen sanksioneve të duhura nëse nuk i kryejnë auditimet në përputhje me nenin 23, 24 dhe 25.

Neni 27

Shtetet Anëtare sigurojnë të paktën që, pronarët dhe aksionarët e firmave të aprovuara të audituesve dhe anëtarët e organeve administrative dhe mbikëqyrëse të këtyre firmave të cilët nuk i përmbushin personalisht kushtet e parashikuara në nenet nga 3 deri në 19 në një Shtet Anëtar të caktuar, të mos ndërhyjnë në kryerjen e auditimeve në asnjë mënyrë e cila do ta vinte në rrezik pavarësinë e personave fizikë që auditojnë dokumentet e përmendura në nenin 1 pika 1 në emër të këtyre firmave të audituesve.

SEKSIONI IV Publikimi

Neni 28

1. Shtetet Anëtare sigurojnë që të vihen në dispozicion të publikut emrat dhe adresat e të gjithë personave fizikë dhe firmave të audituesve të miratuara prej tyre për të kryer auditime të detyrueshme të dokumenteve të përmendura në nenin 1 pika 1.

2. Gjithashtu, në dispozicion të publikut duhen vendosur edhe të dhënat e mëposhtme në lidhje me secilën firmë të aprovuar të audituesve: (a) emrat dhe adresat e personave fizikë të përmendur në nenin 2 pika 1 germa "b" nën-pika "i" ; dhe

(b) emrat dhe adresat e pronarëve ose aksionarëve të firmës së audituesve;

(c) emrat dhe adresat e anëtarëve të organit administrativ të firmës së audituesve.

3. Kur personit fizik i lejohet të kryejë auditime të detyrueshme të dokumenteve të përmendura në nenin 1 pika 1 në rastin e një shoqërie tregtare në përputhje me kushtet e përmendura në nenin 20, 21 dhe 22, zbatohet pika 1 e këtij neni. Megjithatë, duhet bërë e

ditur kategoria e shoqërisë tregtare, e firmës ose e organeve të ndërmarrjeve në lidhje me të cilat po bëhet auditimi.

SEKSIONI V Dispozita të fundit

Neni 29

Komitetit të Kontaktit, i ngritur me nenin 52 të Direktivës 78/660/KEE, i ngarkohen edhe këto detyra: (a) mundësimi, pa cenuar nenet 169 dhe 170 të Traktatit, i zbatimit të harmonizuar të kësaj Direktive përmes mbledhjeve të rregullta në të cilat të trajtohen problemet praktike që lindin në lidhje me zbatimin e saj;

(b) këshillimi i Komisionit, nëse është e nevojshme, për të bërë shtesa ose ndryshime në këtë Direktivë.

Neni 30

1. Shtetet Anëtare miratojnë dhe zbatojnë akte ligjore, nënligjore dhe administrative të cilat janë të nevojshme për të përmbushur detyrimet ligjore të kësaj Direktive. Shtetet Anëtare informojnë në lidhje me këtë Komisionin.

2. Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që dispozitat e përmendura në pikën 1 të mos zbatohen deri më 1 janar 1990.

3. Shtetet Anëtare kujdesen t'i komunikojnë Komisionit tekstin e dispozitave kryesore të legjislacionit kombëtar që miratojnë në fushën e mbuluar nga kjo Direktivë.

4. Shtetet Anëtare kujdesen t'i komunikojnë Komisionit edhe listat e provimeve të organizuara ose të njohura sipas nenit 4.

Neni 31

Kjo Direktivë u drejtohet Shteteve Anëtare.

Nënshkuar në Bruksel, më 10 prill 1984.

Për Këshillin

Presidenti

C. CHEYSSON

(1) GZ nr. C 112, 13.5.1978, fq. 6 ; GZ nr. C 317, 18.12.1975, fq. 6.

(2) GZ nr. C 140, 5.6.1979, fq. 154.

(3) GZ nr. C 171, 9.7.1979, fq. 30.

(4) GZ nr. L 222, 14.8.1978, fq. 11.

(5) GZ nr. L 193, 18.7.1983, fq. 1.